



Pranuar / Dohetuar Priljetat/Prodato Received/Delivety	26.01.2023	3	viti god yogr.
Organ /Njesia Organ /Jedimca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRISHCK	961/2023		114



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1158/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Kocanëtarë me Ardita Perçukq-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1158/2022 të datës 13.12.2022 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit/Komuna e Kamenicës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 26.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1158/2022 e datës 13.12.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Komuna e Kamenicës duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe nenit 7 e 8 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht me datën 10.11.2022 ka njoftuar lidhur me konkursin, ndërsa me datën 01.12.2022 ka shpallur konkursin e jashtëm për emrin e grupit Specialist i Administrimit të Përgjithshëm lidhur me pozitën "Zyrtar për promovimin e turizmit" në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Diasporë, për klasën e pozitës Profesional 2.

Në bazë të listës së aplikacioneve të datës 12.12.2022, del se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Kamenicës, me datën 12.12.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër Sh.02 Nr.38810, sipas të cilit ankuesi është njoftuar se nuk i plotëson kriteret lidhur me përvojën e punës për pozitën e lartcekur si dhe i njëjti nuk ka bashkangjitur certifikatën si dëshmi që nuk është nën hetime nga gjykata.

Ankuesi, përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmsnck@rks-gov.net me datën 12.12.2022, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 7953/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila në Këshill është regjistruar me datën 13.12.2022, me pretendimet ankimore për mos përfshirje në listën e ngushtë si dhe i njëjti deklaroi se në konkursin paraprak për këtë pozitë i kishte plotësuar kriteret.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, komform dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 22.12.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Kamenicës. Ndërsa, Këshilli me datën 06.01.2023 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen në ankesë nga kjo e fundit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 7953/2022 të datës 13.12.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër Sh.02Nr.38810 të datës 12.12.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Konkursin e datës 01.12.2022 me numër të referencës RN00010408; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 22.12.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 06.01.2023 nga Komuna e Kamenicës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Shkresën zyrtare me numër Nr.176/12.12.2022 lidhur me verifikimin paraprak të kandidatëve nga kjo procedurë; Shkresën zyrtare me numër Nr.179/19.12.2022 lidhur me verifikimin paraprak dhe listën e kandidatëve të aprovuar; Aplikacionin e punësimit të ankuesit të datës 01.12.2022 së bashku me dëshminë mbi përvojën e punës, profesionale, certifikatat e trajnimeve si dhe kopjen e pasaportës; Aplikacionin e punësimit të kandidatës N.SH. të datës 05.12.2022 së bashku me dëshminë mbi përvojën e punës, profesionale, certifikatat e trajnimeve si dhe kopjen e letërnjoftimit dhe Vendimin me numër Sh.02Nr.38813 të datës 12.12.2022 lidhur me mos përfshirjen në listën e ngushtë; Aplikacionin e punësimit të kandidatës F.R.M të datës 05.12.2022 së bashku me kopjen e pasaportës dhe certifikatën nga gjykata si dhe Vendimin Sh.02Nr.38806 të datës 25.11.2022 lidhur me mos përfshirjen në listën e ngushtë; Aplikacionin e punësimit të kandidatit E.D të datës 06.12.2022 së bashku me dëshminë mbi përvojën e punës, certifikatat e trajnimeve si dhe kopjen e letërnjoftimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është palejuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar se ankuesi në bazë të Vendimit Sh.02Nr.38810 të datës 12.12.2022 është njoftuar lidhur me mos përfshirjen në listën e ngushtë, ngase i njëjti nuk i ka plotësuar kushtet e konkursit për pjesën e përvojës së punës dhe nuk ka bashkangjitur certifikatën lidhur me dëshminë që nuk është nën hetime. Sipas këtij vendimi, përmes këshillës juridike të njëjtit i është dhënë e drejta për ushtrimin e ankesës brenda afatit prej tri (3) ditëve, tek Njësia e Burimeve Njerëzore, ndërsa ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, nuk ka sjell asnjë dëshmi lidhur me parashtrimin e mjetit juridik-ankesës tek kjo e fundit, lidhur me refuzimin e aplikacionit për pozitën e lartcekur. Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore të Komunës së Kamenicës, ndërlidhur me situatën në fjalë me datën 05.01.2023 përmes shkresës zyrtare me numër Sh.02Nr.201, ka dhënë

përgjigjen në ankesën e ankuesit, me ç'rast i njëjti ka deklaruar se citoj: *"Po ashtu i njëjti nuk ushtron fare ankesë ndaj vendimit për refuzim në verifikimin paraprak...";* si rrjedhojë bazuar në konstatimin e mësipërm ankuesi me këtë rast nuk ka vepruar sipas nenit 15 paragrafit 6 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *6. "Brenda tre (3) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet më shkrim pranë Njesisë Përgjegjëse. Ankesa shqyrtohet nga Njësia Përgjegjëse e cila me vendim e njofton kandidatin brenda pesë (5) ditëve nga paraqitja e saj" ..*

Bazuar si më sipër, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër një procesi të pranimit në shërbimin civil, parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës së brendshme të ankesës tek organi përkatës siç parashihet me nenin 31 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"1.Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtrrojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli") . 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet",* si rrjedhojë meqenëse nuk ka asnjë dëshmi që ankuesi të ketë parashtruar ankesë të brendshme tek organi i punësimit, atëherë sipas Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, kandidatit në procedurë të pranimit nuk i lejohet të parashtrroj ankesë drejtpërdrejtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pa i shterur procedurat e brendshme të ankimimit, mbi këtë bazë ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është në kundërshtim me nenin 16 paragrafin 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *"Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe",* po ashtu ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është në kundërshtim edhe me nenin 125 paragrafin 1 dhe nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, dhe si e tillë është e papranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje



Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1158/2022.

Ardita Percuku-Shyti

[Signature]
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref Shabani

[Signature]
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Kamenicës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Kamenicës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

